



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 2 Datë 09.01.2003

PËR
MIRATIMIN E KRYERJES SË STUDIMIT “ MBI VLERËSIMIN E PASOJAVE,
NDIKIMIT MJEDISOR, PROBLEMEVE HIDRODINAMIKE DHE
REHABILITIMIN E GJËNDJES NË SHTRETËRIT E LUMENJVE”

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të kryhet studimi “**Mbi vlerësimin e pasojave, ndikimit mjedisor, problemeve hidrodinamike dhe rehabilitimin e gjëndjes në shtretërit e lumenjve.**” në të gjithë shtretërit e lumenjve të vendit tonë, brenda vitit 2003.
2. Për kryerjen e këtij studimi ngarkohen institucionet shkencore të Akademisë së Shkencave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, etj.
3. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit që të hartojnë e të dërgojnë për miratim në Këshillin e Ministrave projekt-vendimin për financimin e këtij studimi, brenda muajit Mars 2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Fatos NANO